

Ballkani
Perëndimor: Pjesa
që mungon për
Evropë të plotë



FORUMI I
PRESPËS
PËR DIALOG



Republika e Maqedonisë së Veriut me nënshkrimin e Marrëveshjes finale për zgjidhjen e dallimeve rreth emrit me Greqinë (të a.q. Marrëveshja e Prespës) dhe me nënshkrimin e Marrëveshjes për Miqësi, Fqinjësi të Mirë dhe Bashkëpunim me Bullgarinë, paraqet një shembull unik të shtetit, e cila, për të realizuar qëllimet e saja strategjike, me qasje kreative dhe konstruktive, gjeti zgjidhje për çështjet e hapura bilaterale me fqinjët. Gjithashtu, me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit u vendosën themele të reja bashkëkohore të rregullimit të saj të brendshëm. Në këtë mënyrë, vendi ynë promovohet me kontribuues aktiv në ndërtimin dhe përfundimin e bashkëpunimit rajonal, stabilitetit dhe marrëdhënieve të mira ndërfaqinësore, dhe njëkohësisht edhe si model i rrallë i suksesshëm i shoqërisë funksionale multietnike.

Nga vendi i cili në faza të ndryshme të së kaluarës së tij tranzitore, ishte pjesë e nevojës për angazhim ndërkombëtarë aktiv për tejkalimin e krizave dhe sfidave serioze – konflikti në vitin 2001 dhe kriza politike para vitit 2017, me çka seriozisht u rritua kredibiliteti ndërkombëtar i shtetit - në periudhë shumë të shkurtër arriti të ngrihet në mënyrë demokratike, me sukses ta zbatojë agjendën vendore reformuese dhe të udhëheqë politikë të jashtme të suksesshme. Momentumi i ri, nënkuptonte dinamikë të re jo vetëm në marrëdhëniet me fqinjët, por edhe më gjerë, në marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare, me fokus bashkëpunimin me vendet e demokracisë perëndimore dhe hapjen e rrugës për realizimin e qëllimeve strategjike të vendit për anëtarësimin e plotë në NATO dhe BE.

Këto marrëveshje janë shembull unik në rajonin e Evropës Juglindore dhe më gjerë, për atë se si duhet të ndërtohen ura për tejkalimin e dallimeve, për rritjen e besimit të ndërsjellë, për të përfunduar qytetarët përtej kufijve dhe për prosperitetin e tyre. Duke i zbatuar në praktikë modelet evropiane për zgjidhjen e çështjeve të hapura, me vullnet të mirë dhe dialog, vendi ynë në një mënyrë shumë konkrete manifestoi përcaktim politik dhe leadership me qëllim ndërtimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve me fqinjët dhe partnerët ndërkombëtarë. Marrëveshjet, në sinergji me zbatimin e suksesshëm të agjendës së reformave, e determinuan dhe përfunduan pozitën e vendit në plan ndërkombëtar, dhe gjithsesi, mundësuan hapërim kyç në arritjen e qëllimeve strategjike. Vendi, edhe në plan diplomatik dhe ndërkombëtar, u bë shembull të cilin liderë evropianë dhe globalë e tregojnë si një histori suksesi.



Konferenca e parë ndërkombëtare në korniza të FPD-së planifikohet të mbahet në **Ohër dhe Oteshevë/ Prespë, më 1 dhe 2 korrik 2021**, për arsye se: në Ohër u nënshkrua Marrëveshja Kornizë e Ohrit, qyteti ndodhet relativisht afër Prespës dhe ka infrastrukturën e nevojshme që mundëson organizimin e një ngjarje të madhe ndërkombëtare, si dhe periudha kohore përkon me atë të nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës.

Ngjarja qendrore do të mbahej nën kujdesin e Kryetarit të Qeverisë, me pjesëmarrje të krerëve të shteteve ose qeverive, politikanëve dhe diplomatëve të rangut të lartë nga rajoni, nga vende tjera evropiane dhe jo-evropiane, organizatave ndërkombëtare dhe rajonale - OKB, BE, NATO, Këshilli i Evropës, OSBE, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, CEI dhe të tjera. Autoritetet lokale nga tre vendet e rajonit të Prespës, figura të shquara nga komuniteti akademik, biznesi dhe media, shoqëria civile, organizatat rinore dhe të tjerë. Puna e forumit do të zhvillohej duke mbajtur dy seanca plenare, si dhe disa panele tematike dhe ngjarje të tjera përcjellëse.



Ideja fillestare për inicim të FPD lidhet me projektin "BE për Prespën" të dedikuar për mbështetje dhe zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Prespës, përfshirë edhe bashkëpunimin me komunat kufitare në R. Greqisë dhe të R. Shqipërisë, me një vlerë totale prej 18 milionë euro. Gjithashtu projekti parashikon edhe ndërtimin e një Qendre Multimediale për Dialog dhe për Zhvillim të Vlerave Evropiane në Prespë, e cila do të ishte funksionale gjatë gjithë vitit, duke organizuar punëtori, tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca, etj, me pjesëmarrje të një rrethi të gjerë njerëzish me profile, njohuri dhe përvojë të ndryshme dhe në të do të punësoheshin kryesisht të rinj. Qendra, njëherësh do të jetë edhe baza e organizatave të shoqërisë civile të cilat do të jepnin iniciativat e tyre për zhvillimin e rajonit të Prespës që e ndajnë të tre vendet. Ideja është që Forumi i Prespës për Dialog të mbahet pikërisht në këtë Qendër, por për shkak të krizës shëndetësore, ndërtimi i Qendrës do të realizohet në një fazë të mëvonshme.



Duke pasur parasysh mbështetjen ndërkombëtare për marrëveshjet e theksuara, përvojën e fituar në zbatimin e tyre dhe sfidat që paraqiten në atë plan, e që e gjitha së bashku ia vlen të ndahet me rajonin dhe botën, si dhe të dërgohet mesazh për "know-how" burimor lidhur me dialogun, bashkëpunimin dhe zgjidhjen e çështjeve të hapura bilaterale, Qeveria e Maqedonisë së Veriut solli vendim për krijimin e Forumit të Prespës për Dialog (FPD).

FPD arsyen "raison d'être" e bazon pikërisht në mesazhet dhe përvojat e tri marrëveshjeve dhe zhvillimin e Maqedonisë së Veriut në një shtet modern, demokratik dhe multi-etnik, të bazuar në vlerat evropiane. Gjithsesi, përvojat dhe sfidat e vendeve të tjera në rajon dhe më gjerë në zbatimin e një sërë marrëveshjesh bilaterale dhe rajonale, do të paraqesin vlerë shtesë për FPD.

FPD duhet të mundësojë një debat të frytshëm intelektual dhe politik, në formë të takimeve formale dhe joformale, midis burështetasve, udhëheqësve politikë, diplomatëve, intelektualëve të shquar, përfaqësuesve të komunitetit akademik, të biznesit dhe medias, autoriteteve lokale, shoqërisë civile, të rinjve dhe të tjerëve, prej nga do të dalin ide për procese, zgjidhje praktike dhe përgjigje të mundshme për çështjet e hapura dhe aktuale me karakter rajonal dhe global, dhe natyrisht, do të jenë nxitje thelbësore për avancimin dhe pasurimin e bashkëpunimit rajonal. Në këtë kontekst, me rëndësi të veçantë do të jetë diskutimi mbi perspektivën evropiane të zgjerimit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, realizimi i së cilës do të mundësojë që gjeneratat e ardhshme nga rajoni të jetojnë në Bashkimin Evropian, e cili është shumë më tepër sesa një treg i përbashkët dhe pa kufij. Do të jenë aleatë dhe miq në unionin e vlerave.

Qëllimi kryesor i FPD është promovimi i tij si një platformë dhe vend për:

- ndërtimin e urave dhe kulturës së miqësisë dhe mirëbesimit, mirëkuptimit e ndërsjellë dhe bashkëpunimin reciprok, afrimin e popujve, tejkalimin e stereotipave, shkëmbimin e përvojave dhe "leksioneve të mësuara" lidhur me pajtimin mes shoqërive, popujve ose vendeve të ndryshme;
- zhvillimin dhe promovimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të fqinjësisë së mirë, shkëmbimin e pikëpamjeve për zgjidhjet e mundshme për çështje të pazgjidhura bilaterale, përfshirë edhe ato të natyrës historike, kulturologjike dhe gjuhësore, duke dhënë një kontribut sa më konkret për qeveritë, institucionet dhe shoqërinë civile, përfshirë të rinjtë, që në vazhdimësi të mobilizohen dhe të ndihmojnë në zbatimin e qëndrueshëm të frymës dhe fjalës së marrëveshjeve dypalëshe dhe rajonale të nënshkruara;
- përf forcimin e stabilitetit rajonal dhe pasurimin e bashkëpunimit rajonal, si dhe ndërtimin e një imazhi pozitiv për vendet në rajon në nivelin ndërkombëtar, në kontekst të integritetit evropian;
- debate mbi tema globale siç është Evropa post-pandemike, gjegjësisht se si pasojat e krizës shëndetësore ndikojnë në realizimin e prioriteteve të përcaktuara të BE-së, si dhe shkallën në të cilën ato reflektohen në marrëdhëniet e brendshme të BE-së, si dhe në marrëdhëniet e BE-së me faktorë të tjerë globalë (SHBA, Rusi, Kinë), marrëdhëniet transatlantike në kontekstin e rëndësisë së tyre për stabilitetin dhe perspektivën e rajonit.

Ideja është që forumi të mos jetë një ngjarje që do të mbahet vetëm një herë në vit, por gjatë gjithë vitit dhe nën ombrellën e tij të organizohen ngjarje të tjera më të vogla në formë të punëtorive tematike, seminareve, tryezave të rrumbullakëta e të tjera, dhe në këtë mënyrë të shndërrohet në një lloj brendi që do ta bënte vendin tonë edhe më të njohur ndërkombëtarisht.

Imazhi i fituar pozitiv për Maqedoninë e Veriut dhe sukseset e dukshme në plan të brendshëm dhe të jashtëm, krijojnë parakushte të favorshme që projekti të ofrojë produkt cilësor që do të kontribuojë në afirmimin e tij të mëtejshëm.



URË DREJT SË ARDHMES TË PËRBASHKËT



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Република Северна Македонија
Министерство за надворешни работи



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Punëve të Jashtme